



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:183899

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06140839

**CA.nr.9353/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore propozuesve të sigurimit N.T., M.T., H.T., N.T.–V., N.T.–M., A.T. dhe A.T., që të gjithë nga Kaçaniku, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.Sh., avokat në Ferizaj, kundër kundërshtares të sigurimit Komuna e Kaçanikut, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson I.L., me objekt kontesti propozimi për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së propozuesve të sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, 2024:183899, të datës 31.07.2024, në seancë e kolegjit të mbajtur me datë 09.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e propozuesve të sigurimit N.T., M.T., H.T., N.T.–V., N.T.–M., A.T. dhe A.T., që të gjithë nga Kaçaniku, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj–Dega në Kaçanik, me numër të lëndës 2024:183899, i datës 31.07.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, me aktvendimin e atakuar 2024:183899, të datës 31.07.2024, ka vendosur si në vijim: “ I. REFUZOHET propozimi i propozuesëve, N.T., M.T., H.T., N.T.-V., N.T.-M., A.T. dhe A.T., të gjithë nga Kaçanik, i ushtruar më datën 01.07.2024, ndaj kundër propozuesit Komuna e Kaçanikut me të cilën ka kërkuar CAKTIMIN e masës së sigurimit, ashtu që ti ndalohet kundër propozuesit Komuna e Kaçanikut, qe njësinë kadastrale numër ..., në vendin e quajtur “N.”, me kultur tokë tjetër, në sipërfaqe 625m<sup>2</sup> , ta tjetërsoj, ngarkoj, me ndonjë barrë, apo ta ndryshoj gjendjen faktike, me ndonjë veprim tjetër, me të cilën do ta pamundësonte realizimin e kërkesës së propozuesit; Po ashtu ka kërkuar, qe të CAKTOHET masa e sigurisë. në atë mënyrë qe kundër propozuesit të i ndalohet kundër përmbarimi, i cili zhvillohet sipas lëndës E.nr. 35/21, i datës 07.09.2021, këto masa të vlejné deri në përfundim të procedurës civile në lëndë me numër 2021: 233213, me vendim të formë së prerë, në tersi SI E PA BAZUAR; II. DETYROHEN, propozuesit qe në mënyrë solidar kësaj gjykate, ta paguajnë shumën prej 30.00€, në emër të taksës për propozim, e cila pagës do të bëhet në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit”.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë propozuesit e sigurimit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën e propozuesve të sigurimit, në atë mënyrë që ta anulojë aktvendimin e atakuar dhe të caktohet masa e sigurisë në njësinë kadastrale me nr..., në vendin e quajtur “N.”, me kulturë tokë tjetër, në sipërfaqe prej 625m<sup>2</sup>, si dhe të iu ndalohej kundër përmbartimi kundër propozueses Komuna e Kaçanikut, i cili evidentohet me E.nr.35/21, i datës 07.09.2021, derisa lënda e cila evidentohet me C.nr.233212/21 lidhur me vërtetimin e pronësisë të merr formën e prerë ose në të kundërtën kjo çështje të kthehet në rigjykim apo rishqyrtim.

Kundërshtarja e sigurimit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën propozuesve të masës së sigurimit.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së gjeti se:

Ankesa e propozuesve të masës së sigurimit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesit e sigurimit, me datë 03.05.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur propozimin për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit Komuna e Kaçanikut, të cilin propozim e ka rregulluar në aspektin subjektiv dhe objektiv përmes parashtrësës së datës 19.07.2024, me kërkesën e specifikuar si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar. Caktimin e masës së sigurimit propozuesit e kanë arsyetuar me pretendimin se kjo pronë është e shpronësuar, por e njëjta nuk është kompensuar dhe pa bazë juridike vazhdon të evidentohet në emër të kundër propozueses, ndonëse e njëjta ka pasur për obligim që pronën e shpronësuar ta kompensoj ashtu siç parashihet me ligj. Kundërshtarja e sigurimit në përgjigje në propozim dhe në seancën dëgjimore e ka kundërshtuar propozimin e propozuesve me arsyetimin se i njëjti nuk ka bazë ligjore pasi që prona kontestuese evidentohet në emër të kundër propozueses dhe atë si P.SH. BVI e banimit, rregullimit dhe shfrytëzimi të tokës ndërtimore, si dhe për faktin se me disa vendime të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Themelore në Kaçanik është vendosur në lidhje me këtë çështje, çdo herë në favor të kundër propozueses, andaj ka propozuar që propozimi i propozuesve të refuzohet.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas propozimit të palës propozuese për caktimin e masës së sigurimit, ka marrë aktvendimin e atakuar, 2024:183899, të datës 31.07.2024, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, me përmbajtje sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të këtij aktvendimi gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit, analizimit dhe vlerësimit të provave ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit është i pabazuar. Gjykata thekson nga certifikata e pronës me numër ... vërtetohet se njësia kadastrale kontestuese evidentohet në emër të kundër propozuesit si P.H. BVI e banimit, rregullimit dhe shfrytëzimit të tokës ndërtimore, si rrjedhojë propozuesit juridikisht nuk gëzojnë asnjë të drejtë të disponimit me pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër. Andaj, duke iu referuar kushteve për caktimin e masës së sigurimit të përcaktuara me nenin 297 par.1 të LPK-së, sipas vlerësimit të gjykatës propozuesit e sigurimit nuk e kanë bërë të besueshme

kërkesën e tyre apo të drejtën subjektive. Për më tepër, gjykata ka theksuar se Gjykata Supreme propozuesve ua ka refuzuar kërkesën, fakt ky me të cilin vërtetohet e kundërta e asaj që pretendojnë propozuesit. Refuzimin e kërkesës për ndalimin e procedurës përmbarimore sipas lëndës E.nr.35/21 gjykata e arsyetoi me faktin së në procedurën përmbarimore nuk parashihen masa të sigurisë. Sa i përket bazës ligjore, gjykata është mbështetur në nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, protokollin 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nenin 18 të LPDTS dhe nenin 306.1 të LPK-së. Për detyrimin e propozuesit në pagesën e taksës për propozim, gjykata u mbështet në nenin 12 pika 12.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala propozuese me ankesë.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore të propozuesve se aktvendimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftuar për faktin vendimtar lidhur me mos plotësimin e kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, dhe në këtë drejtim aktvendimi në fjalë nuk është kundërthënës me përmbajtjen e dokumenteve dhe provave të paraqitura ashtu siç theksohet në ankesë.

Gjykata e Apelit në tërësi mbështet vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket çështjes së vlerësimit të plotësimin të kushteve në mënyre kumulative për caktimin e masës së sigurisë, ashtu siç është përcaktuar më nenin 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së, sipas së cilës: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev.nr.343/2019, të datës 24.12.2020, është konstatuar se me aktvendimin nr.465-26/86, të datës 21.01.1987, të lëshuar nga organi i autorizuar, është shpronësuar ngastra kadastrale kontestuese nr..., me sipërfaqe prej 992 m<sup>2</sup>. Kërkesën e paditësve që të vërtetohet se janë bashkëpronarë në pjesë ideale prej 1/3 e ngastrës kadastrale ..., me sipërfaqe prej 367 metra katrorë, në Zonën Kadastrale Kaçanik, Gjykata Supreme e ka refuzuar me arsyetimin se propozuesit nuk kanë qenë me mirëbesim dhe në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore të fitimit të pronësisë mbi bazën e parashkrimit. Ndërsa, refuzimin e kërkesës së paditësve që të detyrohet këtu kundër propozuesja e sigurimit që t’ua paguaj shumën prej 293,500.00 euro në emër të kompensimi për eksproprijimin e pjesës së ngastrës kadastrale ..., me sipërfaqe prej 625 m<sup>2</sup>, Gjykata Supreme e ka arsyetuar me faktin se kërkesat e tilla vjetërsohen për 10 vite, e në rastin konkret këtu propozuesit nuk kanë mundur të dëshmojnë se brenda këtij afati ligjor kanë kërkuar

kompensimin. Vlen të theksohet se propozuesit e sigurimit kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurimit në ngastrën kadastrale me nr..., në sipërfaqe prej 625m<sup>2</sup>, për të cilën më parë Gjykata Supreme e ka refuzuar kërkesën e tyre për kompensim në emër të eksproprijimit. Sipas vlerësimi të Gjykatës së Apelit caktimi i masës së sigurimit ka për qëllim sigurimin e kërkesës kryesore që kërkohet me padi, kur ekziston rreziku se pa caktimin e një masë të tillë pala kundërshtarë mund të pamundësojë apo vështirësojë realizimin e kërkesës. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se propozuesit e sigurimit përsëri kanë paraqitur padi e cila evidentohet me numër të lëndës C.nr.233213/21, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 20.09.2023, ku mes tjerash kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të eksproprijimit për ngastrën kontestuese ..., me sipërfaqe prej 625m<sup>2</sup>, në vendin "N.", të bëjë kompensimin në para sipas ekspertizës përkatëse ose të bëjë kompensimin me paluajtshmëri tjetër adekuate ose ngastra kontestuese të kthehet në pronësi të paditësve - propozuesve. Andaj, duke u nisur nga këto rrethana, Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së propozuesit e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive, siç përcaktohet me nenin 297 par.1 pika a) të LPK-së.

Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se propozuesit e sigurimit përveç se nuk e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e të drejtës subjektive, me asnjë provë dhe asnjë rrethanë nuk e kanë bërë të besueshme ekzistimin e ndonjë rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit të propozuar të njëjtës do t'i pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës apo në ndonjë formë do të ndryshonte gjendja ekzistuese. Sipas vlerësimi të Gjykatës së Apelit, fakti së propozuesit e sigurimit kanë iniciuar proces gjyqësor për vërtetimin e të drejtës së pronësisë ndaj kundërshtares së sigurimit nuk është i mjaftueshëm për ta provuar ekzistimin e rrezikut, pasi që rreziku duhet të ekzistoj dhe të vlerësohet në raport me veprimet konkrete të ndërmarra nga kundërshtarja e sigurimit në lidhje me ngastrën lëndore. Në rastin konkret propozuesit e sigurimit nuk i kanë paraqitur gjykatës asnjë provë madje as informacion së cilat veprime i ka ndërmarrë kundërshtarja e sigurimit në lidhje me ngastrën në fjalë e të cilat do të përbënin rrezik real. Andaj, nga këto arsye kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar në mënyre komulative kushtet për caktimin e masës së sigurimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së.

Lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit në atë mënyrë që kundër propozuesit t'i ndalohet kundër përmbarimi i cili evidentohet E.nr.35/21, të datës 07.09.2021 deri sa lënda C.nr.233213/21 lidhur me vërtetimin e pronësisë të merr formën e prerë, Gjykata e Apelit e vlerëson si të drejtë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kësaj kërkesë. Sipas vlerësimi të Gjykatës së Apelit, arsyeja pse nuk mund të lëshohet masa e sigurisë në këtë rast ka të bëjë me faktin se mënyra se si është parashtruar kërkesa për masën e sigurisë paraqet ndërhyrje në procedurë tjetër në këtë rast në procedurën përmbarimore e cila siç shihet nga shkresat e lëndës është duke u zhvilluar në mes të palëve ndërgjyqëse. Gjykata vë në dukje se Ligji i Procedurës Përmbarimore, garanton mjete efektive juridike që propozuesit e masës së sigurisë mund të ushtrojnë ndaj procedurës përmbarimore të inicuar, pra mbrojtja juridike mund të kërkohet brenda asaj procedure, kurse në rastin konkret nuk mundet që me kërkesë për masë të sigurisë sipas LPK-së, të ndërhyhet në procedurë tjetër, pasi që këto dy procedura paraqiten të jenë të ndara nga njëra tjetra.

Numri i lëndës: 2024:183899  
Datë: 10.09.2024  
Numri i dokumentit: 06140839

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CA.nr.9353/2024, datë 09.09.2024

Kryetari i kolegjit – Gjyqtari  
Hysni Bardheci